



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 9 Prot.

Tiranë, më 5 . 1 . 2026

URDHËR

Nr. 01 , datë 5 . 1 . 2026

PËR

SHPALLJEN E KONKURRIMIT PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR GJIROKASTËR-LIBOHOVË.

Në mbështetje të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, të urdhrit nr. 571, datë 18.11.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”, të urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin e drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë - Libohovë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Procedura e konkurrimit për pozicionin e drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë - Libohovë, do të kryhet në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për pozicionin e drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë - Libohovë do të jetë deri në datën 19.01.2026.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedura që do të ndiqet për konkurrimin për pozicionin e drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë - Libohovë, të bëhet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë-Libohovë dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Zëvendës-drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI



SHTOJCA 1

SHPALLJE PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR GJIROKASTËR-LIBOHOVË.

Në mbështetje të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 13, të kreut III, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, të urdhrit nr. 571, datë 18.11.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar shpall procedurat e konkurrimit për pozicionin e:

- Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë-Libohovë.

I. KËRKESAT E PËRGJITHSHME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
6. Të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

II. KËRKESAT E POSAÇME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në fushën e edukimit.
2. Të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në institucionet e administratës publike, ose në institucionet që ofrojnë shërbime arsimore.
3. Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe kualifikimet në fushën e arsimit, përbëjnë avantazh (dëshmi, certifikata).

III. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
2. Letër motivimi;
3. Diplomë arsimit të lartë (*Për diplomat e fituara jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë*);
4. Listë notash e noterizuar për ciklet e studimeve;
5. Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
6. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
7. Fotokopje e kartës së identitetit;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
11. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
12. Vërtetim nga gjykata që nuk ka proces penal.

Të gjitha dokumentat që janë fotokopje duhet të dorëzohen të njësuara me origjinalin.

Aplikimi i shoqëruar me dokumentet e sipërcituar do të dorëzohen nga kandidatët nëpërmjet shërbimit postar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, në adresën: Rruga “Aleksandër Moisiu”, Tiranë.

IV. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR GJIROKASTËR-LIBOHOVË

- a. kontrollon dhe garanton përmbushjen e misionit dhe objektivave të drejtorisë dhe të detyrimeve që ka ZVAP-ja.
- b. përfaqëson ZVAP-në në marrëdhëniet me të tretët, si dhe autorizon personat që mund të përfaqësojnë zyrën në mungesë të tij.
- c. drejton dhe kontrollon veprimtarinë e zyrës, nëpërmjet akteve të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga punonjësit e zyrës.
- d. përgjigjet përpara Drejtorit të Përgjithshëm për zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe raporton përpara Drejtorit Rajonal për sigurimin e mbarëvajtjes së administrimit financiar, burimeve njerëzore, veprimtarisë arkivore dhe dokumentare dhe aktiveve të zyrës në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
- e. merr në shqyrtim dhe adreson rekomandimet apo sugjerimet e brendshme apo të jashtme me qëllim përmirësimin e praktikave apo procedurave të zbatuara nga punonjësit e Zyrës.
- f. informon në mënyrë periodike, Drejtorin e DRAP, për problemet e ndryshme në lidhje me planet e punës apo arritjen e objektivave.
- g. kryen delegimin e detyrave mbi çështjet që i drejtohen për trajtim dhe zgjidhje ZVAP-së.

V. VERIFIKIMI DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E LISTËS PËRFUNDIMTARE

Në përfundim të afatit të aplikimit, Komisioni *ad-hoc* pas shqytimit të dosjeve të aplikantëve do të shpallë, brenda 3 (tre) ditëve pune listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar : (<https://arsimiparauniversitar.gov.al>).

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe/ose të posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore, për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së e-mail të deklaruar nga çdo kandidat.

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtën e ankimimit brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja dijeni për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së email-it të deklaruar prej tyre. Ankuesit do t'i kthehet përgjigje brenda 2 (dy) ditëve pune duke filluar nga data e përfundimit të afatit të ankimimit.

Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar do të shpallet në datën 30.01.2026, në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar: (<https://arsimiparauniversitar.gov.al>). Në të njëjtën datë do të shpallet dhe njoftimi për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

VI. FUSHAT E NJOHURIVE MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

1. Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
4. Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
5. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
6. Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar.
7. Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

8. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar.
9. Akte ligjore dhe nënligjore të MAS-it në fushën e arsimit parauniversitar dhe funksionimit të AKAP-it;

VII. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen:

1. Vlerësimi i testimit me shkrim, deri në 60 pikë.
2. Vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë.
3. Vlerësimi për jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Për të kaluar në fazën e intervistës së strukturuar me gojë çdo kandidat duhet të marrë të paktën 30 (tridhjetë) pikë në testimin me shkrim.

VIII. SHPALLJA E FITUESIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Fituesi do të shpallet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar: <https://arsimiparauniversitar.gov.al>.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së tyre të email-it.